



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2019:235769

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05438331

C.nr.1300/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, me bashkëpunëtoren profesionale Diellza Zeqiri Latifi, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit F.H nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.R.M, nga Vushtrria, kundër të paditurve H.H nga Komuna e Vushtrrisë dhe Xh.Sh e vajzërisë H. nga Komuna e Vushtrrisë për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë mbi bazën e trashëgimisë, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datës 22.02.2024, në rivendosje sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr.2236/20 të datës 21.11.2023, jashtë seance, me datën 12.03.2024, e mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësit F.H nga Prishtina, kundër të paditurve H.H nga Komuna e Vushtrrisë dhe Xh.Sh e vajzërisë H. nga Komuna e Vushtrrisë, me të cilën ka kërkuar që “Të aprovohet në tërësi e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe të vërtetohet se të njëjtit i ka takuar tërë pasuria e patundshme dhe atë në ngastrat kadastrale P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 me një sipërfaqe prej 2,915m<sup>2</sup>, P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 m një sipërfaqe prej 1,970m<sup>2</sup> dhe P... në vendin e quajtur L... me kulturë arë e klasës 4 me një sipërfaqe prej 4,510 m<sup>2</sup> të cilat evidentohen në ZK.”, si e pa bazuar.

II. Secila pale i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Paditësi F.H nga Prishtina, përmes të autorizuarit të tij av.R.M nga Vushtrria më dt.28.08.2018 ka ushtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi bazën e trashëgimisë kundër të paditurve H.H nga Komuna e Vushtrrisë dhe Xh.Sh e vajzërisë H. nga Komuna e Vushtrrisë, me të cilën ka kërkuar që përveç pjesës ideale prej 2/4 që paditësi tashmë është pronar mbi bazën e trashëgimisë, të vërtetohet se të njëjtit i takon edhe pjesa tjetër ideale prej 2/4 e masës pasurore dhe atë ¼ nga pjesa ideale e të paditurit të parë H.H dhe ¼ nga pjesa ideale e të paditurit të dytë Xh.Sh H. në ngastrat kadastrale P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 me një sipërfaqe prej 2,915m<sup>2</sup>, P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 m një sipërfaqe prej 1,970m<sup>2</sup> dhe P... në vendin e quajtur L... me kulturë arë e klasës 4 me një sipërfaqe prej 4,510 m<sup>2</sup>. Tutje ka shtuar se i padituri H.H me aktvendimin TR.nr.69/2002 i dt.09.05.2021 i lëshuar nga Gjykata Komunale në Vushtrri, pa njoftimin e trashëgimtarëve tjerë e ka bërë shqyrtimin e trashëgimisë dhe është shpallur trashëgimtar ligjor në ngastrën katastrale 526 në vendin e quajtur “L...” me kulturë arë e klasës VI me një sipërfaqe prej 0.33,20 ha, ku kjo pasuri i ka takuar me rastin e ndarjes dhe pastaj i njëjti e ka shitur, ndërsa që në raport me të paditurën Xh.Sh i njëjti ka theksuar se është e pajtimit që pjesën ideale prej ¼ e cila i ka takuar me aktvendimin mbi trashëgiminë ta bart në emër të paditësit.

Të paditurit nuk kanë paraqitur përgjigje në padi.

Lidhur me padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit kjo gjykatë ka marrë Aktgjykimin C.nr.383/18 i dt.14.02.2020 me të cilin padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar, ashtu që në raport me të paditurën e dytë paditësit ia ka njohur të drejtën e pronësisë, ndërsa që në raport me të paditurin e parë e ka refuzuar si të pa bazuar. Pas paraqitjes së ankesës nga ana e përfaqësuesit të paditësit, gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin AC.nr.2236/2020 i dt.21.11.2023 ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit dhe ka prishur aktgjykimin e kësaj gjykate, dhe ka kthyer lëndën në rigjykim, duke theksuar se në bazë të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata të shkallës së parë në pikën II e aprovon tërë padinë e paditësit për të gjitha ngastrat e njëjta me sipërfaqe të njëjtë, ndërsa në pikën IV e refuzon kërkesëpadinë e paditësit për të gjitha ngastrat e njëjta me sipërfaqe të njëjtë, duke konstatuar se në bazë të kësaj mënyrë të vendosjes ky aktgjykim nuk mund të ekzaminohet, me rekomandimin që gjykata e shkallës së parë në rigjykim të evitohet të metat e lartpërmendura, duke i zhvilluar të gjitha provat e nevojshme lidhur me kërkesat e palëve ndërgjyqëse dhe në rigjykim pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe rrethanave të sipërpërmendura të merr vendim të drejtë i cili duhet të përmbajë dispozitiv të kuptueshëm, arsye për faktet vendimtare, cilat fakte i ka vërtetuar, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe të merr vendim të bazuar në ligj.

Gjykata pas vlerësimit të rekomandimeve të dhëna në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën seancë ka prezantuar paditësi dhe përfaqësuesi i tij sipas autorizimit, ndërsa kanë munguar të paditurit, ku nga fletë kthesat është vërtetuar se të njëjtit janë ftuar në mënyrë të rregullt dhe se mungesën nuk e kanë arsyetuar, ashtu që përfaqësuesi i paditësit i ka propozuar gjykatës që seanca e shqyrtimit gjyqësor të mbahet në mungesë të të paditurve.

Në seancën gjyqësore të dt.22.02.2024, paditësi dhe përfaqësuesi i tij kanë deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa që në fjalën përfundimtare kanë deklaruar se mbesin pranë padisë dhe kërkesëpadisë edhe më tutje, duke i propozuar gjykatës që e njëjta të aprovohet në tërësi e bazuar, pasi që nga provat e administruara si dhe nga parashtresa e të paditurës së dytë Xh.Sh, e njëjta me parashtresë ia ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi, ndërsa që shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për të vlerësuar drejtë dhe për të vërtetuar saktë gjendjen faktike, duke vepruar sipas propozimit të palëve, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.02.2024 administroi provat dhe atë:

Certifikatat e pronës në emër të paditësit F.H, të paditurit të parë H.H dhe të paditurës së dytë Xh.Sh e vajzërisë H., Aktvendimin për shqyrtimin e trashëgimisë Tr.nr.69/2002, Aktvendimin për shqyrtimin e trashëgimisë CT.nr.15/14, është vështruar librezat e veteranit të luftës e paditësit, u veshtuan shkresat e lëndës sipas numrit CT.nr.15/14, si dhe parashtresa e të paditurës së dytë e dorëzuar në gjykatë më dt.31.10.2019.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga nenit 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), erdhi në përfundim se padia dhe kërkesëpadia e paditësit, duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Nuk është kontestues fakti se paditësi dhe të paditurit janë në lidhje familjare, ku paditësi të paditurin e parë e ka vëlla, ndërsa që të paditurën e dytë e ka motër dhe të gjithë janë pasardhës (fëmijë) të të ndjerit S.H.

Kontestuese për gjykatën është se a duhet të jetë paditësi F.H trashëgimtar i vetëm i masës pasurore të cilën e ka lënë tani i ndjeri S.H. në momentin e vdekjes, i cili tani është pronar në pjesë ideale me 2/4 në ngastrat kadastrale P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3

me një sipërfaqe prej 2,915m<sup>2</sup>, P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 m një sipërfaqe prej 1,970m<sup>2</sup> dhe P... në vendin e quajtur L... me kulturë arë e klasës 4 me një sipërfaqe prej 4,510 m<sup>2</sup> të cilat evidentohen në ZK, ndërsa që të paditurit janë pronar të këtyre ngastrave kadastrale me ¼ në pjesë ideale secili veç e veç.

Deri te kjo gjendje faktike, përkatësisht deri tek vendosja si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata ka ardhur duke u mbështetur në provat e administruara si më lartë, të cilat prova i ka pranuar si të besueshme për faktin se:

Nga Certifikatat e pronës në emër të paditësit F.H, të paditurit të parë H.H dhe të paditurës së dytë Xh.Sh e vajzërisë H., i lëshuar me dt.27.08.2018 vërtetohet se paditësi F.H është pronar në pjesë ideale prej 2/4, i padituri H.H është pronar në pjesë ideale prej ¼ dhe e paditura Xh.Sh është pronare në pjesë ideale prej ¼ në ngastrat kadastrale P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 me një sipërfaqe prej 2,915m<sup>2</sup>, P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 m një sipërfaqe prej 1,970m<sup>2</sup> dhe P... në vendin e quajtur L... me kulturë arë e klasës 4 me një sipërfaqe prej 4,510 m<sup>2</sup>.

Nga aktvendimi për shqyrtimin e trashëgimisë Tr.nr.69/2002, i dt.09.05.2002 vërtetohet se i padituri i parë H.H është shpallur trashëgimtar ligjor në masën trashëgimore pas vdekjes së të ndjerit S. H. ish nga fshati Smrekonicë, e cila është përshkruar në fletën poseduese nr.5 Zona kadastrale Q..., ngastra kadastrale nr... në vendin e quajtur "L..." arë e kl.të IV në një sipërfaqe prej 0,33.20 ha.

Nga aktvendimi për shqyrtimin e trashëgimisë CT.nr.15/14, i dt.14.07.2015 vërtetohet se paditësi F.H në pjesë ideale prej 2/4 të masës trashëgimore dhe të paditurit H.H dhe Xh.Sh në pjesët ideale secili veç e veç prej nga ¼ të masës trashëgimore, pas vdekjes së të ndjerit S. H. ish nga fshati Smrekonicë janë shpallur trashëgimtarë në tërë masën pasurore, e cila evidentohet sipas certifikatës 18/3916 ZK Vushtrri, përkatësisht në ngastrat kadastrale P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 me një sipërfaqe prej 2,915m<sup>2</sup>, P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 m një sipërfaqe prej 1,970m<sup>2</sup>, P... në vendin e quajtur L... me kulturë arë e klasës 4 me një sipërfaqe prej 4,510 m<sup>2</sup> dhe P... në vendin e quajtur P... me kulturë arë e klasës 3 me një sipërfaqe prej 2,663 m<sup>2</sup>.

Nga vështrimi i shkresave të lëndës sipas numrit CT.nr.15/14, vërtetohet se propozimin për shqyrtimin e trashëgimisë e ka paraqitur tani paditësi F.H i cili ka kërkuar nga gjykata që të bëjë shqyrtimin e trashëgimisë të cilën e ka lënë babai i tij i ndjeri S. H., ku pasuria e tij evidentohet në certifikatën mbi të drejtat e pronësisë në paluajtshme 18-3916 e dt.07.11.2013, duke theksuar se si trashëgimtar ligjor i ndjeri ka lënë bijtë F. dhe H.H dhe bijat Xh. dhe F.Sh, të vajzërisë H.

Nga procesverbalet të cilat gjenden në shkresat e lëndës trashëgimore, vërtetohet se trashëgimtari F.H ka deklaruar se e merr masën trashëgimore e cila i takon sipas ligjit dhe vëllait të tij H.H ia mohon të drejtën në trashëgimi, duke theksuar se i njëjti e ka marrë pjesën e tij e cila i ka takuar dhe të njëjtën e ka shitur, ndërsa që trashëgimtarja F.Sh ka deklaruar se e merr masën trashëgimor në favor të vëllait të saj F.H.

Nga ky procesverbal është konstatuar se trashëgimtarja ligjore Xh.Sh nuk është në gjendje të mirë shëndetësore që të jap deklaratë pa prezencën e mjekut neuropsikiatër dhe deklarata e saj është shtyrë deri sa të sigurohet një i tillë. Trashëgimtari ligjor H.H ka deklaruar se e merr pjesën trashëgimore e cila i takon sipas ligjit dhe nuk ua ka kontestuar këtë të drejtë trashëgimtarëve tjerë. Ndërsa pas daljes në terren përkatësisht në vendbanimin e trashëgimtares Xh.Sh, e njëjta ka deklaruar se e merr pjesën e masës trashëgimore e cila i ka takuar sipas ligjit. Ndërsa që nga

certifikata e pronësisë nr.18-3916/13 e dt.07.11.2013 e cila gjendet në shkresat e lëndës vërtetohet se tani i ndjeri S. H. ka qenë pronar i ngastrave katastrale P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 me një sipërfaqe prej 2,915m<sup>2</sup>, P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 m një sipërfaqe prej 1,970m<sup>2</sup>, P... në vendin e quajtur L... me kulturë arë e klasës 4 me një sipërfaqe prej 4,510 m<sup>2</sup> dhe P... në vendin e quajtur P... me kulturë arë e klasës 3 me një sipërfaqe prej 2,663 m<sup>2</sup>. Ndërsa që nga dëshmia mbi vdekjen e tani të ndjerit S. H. vërtetohet se i njëjti ka vdekur më dt.01.04.1992 në S..., ndërsa pas ka lënë pasardhësit e tij (fëmijët) H.H, F.H, Xh.Sh dhe F.Sh.

Nga parashtrësia e të paditurës së dytë e dorëzuar në gjykatë më dt.31.10.2019 vërtetohet se e paditura Xh.Sh nuk e konteston kërkesëpadinë e paditësit – vëllait të saj F.H dhe e njëjta e pranon në tërësi si të bazuar. Kjo parashtrësia nuk është e nënshkruar, por e përmban shenjën e gishtit të të paditurës Xh.Sh.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: nuk ishin kontestuese raportet farefisnore mes të paditësit dhe të paditurve, ku të njëjtit janë pasardhësit e të ndjerit S. H.. Nga Aktvendimi Tr.nr.69/2002, i dt.09.05.2002 për shqyrtimin e trashëgimisë i lëshuar nga kjo gjykatë është vërtetuar se i padituri H.H pas vdekjes së të ndjerit S. H., është shpallur trashëgimtar në masën trashëgimore e cila është përshkruar në fletën poseduese nr.5 Zona kadastrale Q..., ngastra kadastrale nr.... në vendin e quajtur "L..." arë e kl.të IV në një sipërfaqe prej 0,33.20 ha, ndërsa që nga certifikata mbi vdekjen e tani të ndjerit është vërtetuar se trashëgimlënësi si trashëgimtar të radhës së parë të trashëgimisë ka lënë edhe të bijtë H.H, F.H, Xh.Sh dhe F.Sh, të cilët "de facto", nuk janë përfshirë si trashëgimtar ligjor të radhës së parë të trashëgimisë në lëndën Tr.nr.69/2002, i dt.09.05.2002.

Nga aktvendimi CT.nr.15/14, i dt.14.07.2015 është vërtetuar se paditësi F.H në pjesë ideale prej 2/4 të masës trashëgimore dhe të paditurit H.H dhe Xh.Sh në pjesë ideale secili veç e veç prej nga 1/4 të masës trashëgimore, pas vdekjes së të ndjerit S. H. janë shpallur trashëgimtarë në masën trashëgimore, e cila evidentohet sipas certifikatës ... ZK Vushtrri, përkatësisht në ngastrat kadastrale P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 me një sipërfaqe prej 2,915m<sup>2</sup>, P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 m një sipërfaqe prej 1,970m<sup>2</sup>, P... në vendin e quajtur L... me kulturë arë e klasës 4 me një sipërfaqe prej 4,510 m<sup>2</sup> dhe P... në vendin e quajtur P... me kulturë arë e klasës 3 me një sipërfaqe prej 2,663 m<sup>2</sup>. Nga shkresat e lëndës CT.nr.15/14 është vërtetuar se F.Sh – motra e paditësit ka marr pjesën e saj trashëgimore në favor të vëllait të saj F.H, andaj edhe ky i fundit ka trashëguar 2/4 në pjesë ideale të masës trashëgimore, pasi që ka trashëguar edhe pjesën e motrës së tij e cila i ka takuar sipas ligjit.

Gjykata vë në pah faktin se në rastet kur procedura e shqyrtimit të trashëgimisë ka përfunduar duke u mbështetur në dëshminë e vdekjes në të cilën paditësit fare nuk janë deklaruar si trashëgimtar të rendit të parë ligjor, atëherë të njëjtëve, duke mos pasur mundësi ta kundërshtojnë ligjshmërinë e vendimit mbi shqyrtimin e trashëgimisë për shkak se i njëjti ishte bërë i formës së prerë, i'u lind e drejta për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore me padi në gjykatë.

Kjo nënkupton se vendimi mbi shqyrtimin e trashëgimisë është i karakterit deklarativ dhe si i tillë nuk mund të ketë ndikim në vlerësimin e të drejtës në trashëgimi. Ashtu që në rastin konkret padia ka qenë dashur të paraqitet në drejtim të përfshirjes së paditësit në ndarjen e masës trashëgimore të lënë pas vdekjes nga paraardhësi i tyre, përkatësisht i ngastrës kadastrale nr... në vendin e quajtur "L..." arë e kl.të IV në një sipërfaqe prej 0,33.20 ha, e të cilën e ka trashëguar i padituri i parë H.H, si trashëgimtar ligjor i vetëm, duke mos i paraqitur trashëgimtarët tjerë ligjor, mirëpo pasi që padia dhe kërkesëpadia e paditësit është paraqitur në drejtim të masës tjetër trashëgimore të lënë nga de kujusi në momentin e vdekjes, përkatësisht ngastrave katastrale P...

në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 me një sipërfaqe prej 2,915m<sup>2</sup>, P... në vendin e quajtur Ç... me kulturë arë e klasës 3 m një sipërfaqe prej 1,970m<sup>2</sup> dhe P... në vendin e quajtur L... me kulturë arë e klasës 4 me një sipërfaqe prej 4,510 m<sup>2</sup>, duke kërkuar nga gjykata vërtetimin e të drejtës së pronësisë si pronar i vetëm i masës pasurore, në raport me të paditurin e parë me pretendimin se i njëjti e ka marr pjesën e tij pasurore, ndërsa në raport me të paditurën e dytë se e njëjta ka shprehur vullnetin që masën e saj pasurore të cilën e ka fituar nga trashëgimia t'ia kaloj në pronësi paditësit, mirëpo që këto pretendime gjykata i gjeti si të pa bazuara, andaj edhe padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar. Neni 9 i Ligjit mbi Trashëgiminë i Kosovës përcakton se *“Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.”*

Neni 11 i këtij ligji përcakton se *“1.Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre.” dhe “4. Trashëgimtarët e radhës më të afërt të trashëgimisë i përjashtojnë nga trashëgimia personat e radhës më të largët.”*

Neni 12 i këtij ligji përcakton se *“1. Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij. “2. Personat nga paragrafi (1) i këtij neni trashëgojnë në pjesë të barabarta”*.

Andaj sipas aktvendimit CT.nr.15/14 trashëgimtarët ligjor kanë trashëguar në pjesë të barabarta, ku në favor të paditësit e ka marr masën e saj trashëgimore motra e tij F.Sh dhe i njëjti ka trashëguar 2/4 e masës trashëgimore, ndërsa që të paditurit kanë trashëguar me ¼ në pjesë ideale. Duke qenë se në ngastrën katastrale të lartcekur paditësi nuk është thirr si trashëgimtar ligjor, i njëjti është dashur që të kërkoj t'i njihet e drejta e pronësisë edhe në atë pjesë të masës trashëgimore, ndërsa që i padituri i parë sipas dispozitave ligjore të lartcekura ka pasur të drejtë të trashëgoj edhe në masën tjetër trashëgimore të de cujusit dhe një të drejtë të tillë e ka shfrytëzuar. Ndërsa që në raport me të paditurën e dytë, e njëjta ka marr pjesën e saj trashëgimore e cila i ka takuar sipas ligjit, ndërsa që gjykata nuk ka mundur t'ia fal besimin një parashprese të vetme dhe të paditurës t'ia heq të drejtën e pronësisë në masën pasurore e cila evidentohet në emrin e saj në certifikatën e pronësisë, e shtuar faktin se nga vështrimi i shkresave të lëndës CT.nr.15/14 në procesverbal është konstatuar se trashëgimtarja ligjore Xh.Sh nuk është në gjendje të mirë shëndetësore që të jap deklaratë pa prezencën e mjekut neuropsikiatër (shkresat e lëndës trashëgimore).

Gjykata po ashtu ka vlerësuar pretendimet e paditësit i cili ka theksuar se i padituri i parë e ka shitur pjesën e tij nga masa trashëgimore, mirëpo që një pretendim të tillë e gjeti si të pa bazuar për vendosje ndryshe, nga ajo që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që shitja ose tjetërsimi i masës trashëgimore nga ana e të paditurit, nuk ia pamundëson të drejtat paditësit në raport me masën trashëgimore, në të cilën është trashëgimtar i radhës së parë.

E drejta e pronës është kategori kushtetuese e cila e përcakton se e drejta e pronës është e garantuar dhe se askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Po ashtu Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore në nenin 18 ka përcaktuar se *“1. Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti.”*

Gjykata vlerëson se në bazë të nenit 322 par.2 të LPK-së i cili përcakton se: *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*, bazuar edhe në nenin 7 par.1 të LPK-së, i cili

përcakton se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla e si rrjedhojë, pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat e bazon pretendimin e saj”* paditësi nuk kanë arritur që të vërtetojnë pretendimet e tij, përkatësisht që të bëj të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e tij, andaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 450 të LPK-së, pasi që paditësi e ka humbur kontestin, ndërsa që të paditurit nuk i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës, andaj gjykata ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, nga sa e tha më lartë e në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.1300/2023, datë: 12.03.2024

GJYQTARI  
Izet Gërguri

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.